

Vendim nr. 135 datë 12.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 12.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SKËNDER LIÇI, përfaqësuar nga av. Sonila Leci, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-4395 (552), datë 14.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 29, 31 dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 68, 70 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Skënder Liçi ka qenë në marrëdhënie pune me shoqërinë “Kurum International” sh.a. që prej datës 17.08.2011. Në datën 18.06.2012 mes palëve është lidhur kontrata individuale e punës, me kohëzgjatje të pacaktuar, sipas së cilës kërkuesi do të ushtronte detyrën e inxhinierit metalurg.

2. Me shkresën nr. 16/8 prot., datë 06.02.2013, punëdhënësi, shoqëria “Kurum International” sh.a., ka njoftuar punëmarrësin, kërkuesin Skënder Liçi, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit për arsye ekonomike, në bazë të nenit 144 të Kodit të Punës (KP), kurse me shkresën nr. 16/9 prot., datë 06.02.2013 e ka njoftuar për zhvillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në datën 09.02.2013, ora 11:00, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

3. Në datën 09.02.2013 është mbajtur nga punëdhënësi procesverbali i takimit, sipas të cilit punëmarrësi nuk është paraqitur në bisedimet për zgjidhjen e kontratës së punës, ndonëse është njoftuar me shkrim. Me vendimin e datës 12.02.2013 punëdhënësi, shoqëria “Kurum International” sh.a., ka zgjidhur kontratën e punës me punëmarrësin, kërkuesin Skënder Liçi, për shkak të riorganizimit dhe ristrukturimit të vendeve të punës për arsye ekonomike. Sipas këtij vendimi marrëdhëniet financiare ndërpriten në datën 28.02.2013.

4. Kërkuesi, duke e konsideruar zgjidhjen e kontratës së punës në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “Kurum International” sh.a., për shpërblimin e dëmit të ardhur nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e marrëdhënieve të punës me pagën e një viti, shpërblimin e dëmit për shkak të mos njoftimit me pagën e 1 muaji, si dhe shpërblimin e dëmit për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës me pagën e 2 muajve.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 744, datë 30.04.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar të paditurin të dëmshpërblejë paditësin (kërkuesin) në masën e dy pagave mujore, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër, si të pabazuar në ligj dhe prova. Sipas asaj gjykate, edhe pse pala e paditur ka përpiluar njoftimin për takim, mungesa e paditësit rezulton se nuk ka qenë për faj të tij, pasi nuk provohet që ai të ketë marrë dijeni për datën dhe orën e takimit. Sipas gjykatës, për sa kohë që njoftimi për takim nuk konsiderohet i rregullt dhe bindës, edhe procedura vijuese e takimit nuk konsiderohet e kryer rregullisht, për pasojë paditësit i është mohuar e drejta për takim, për marrjen dijeni për arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për të bërë kundërshtimet e tij dhe për t'u shprehur në tërësi në kuptim të përmbajtjes së nenit 144 të KP-së. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, për mosrespektimin e kësaj procedure, sipas nenit 144/5 të KP-së, pala e paditur duhet të dëmshpërblejë paditësin në masën e dy pagave mujore. Kurse për sa i përket themelit të

zgjidhjes së marrëdhënies së punës, gjykata ka vlerësuar se arsyet që e kanë çuar palën e paditur në ndërprerjen e kësaj marrëdhënieje janë të justifikuara. Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e pjesëshëm të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin tërësisht të padisë. Po kështu, ka paraqitur ankim edhe pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin pjesërisht të vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-1278 (567), datë 02.06.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 744, datë 30.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me ndryshimin që pala e paditur të paguajë në favor të kërkuesit pagën e një viti pune si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Sipas gjykatës së apelit, veprimet e paditësit (kërkuesit) në kuadrin e marrëdhënies së punës nuk kanë qenë të tilla që kanë cenuar klimën e mirëbesimit në lidhje me funksionimin e asaj marrëdhënieje, nuk evidentohen shkelje me faj të lehtë në mënyrë të përsëritur ose me faj të rëndë dhe punëdhënësi nuk ka pretenduar shkelje të kushteve të kontratës kolektive dhe individuale të punës. Sipas gjykatës së apelit është i drejtë pretendimi i paditësit për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, ndaj vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet vetëm për sa i përket së drejtës së dëmshpërblimit themelor. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs pala e paditur në procesin gjyqësor, shoqëria “Kurum International” sh.a.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-4395 (552), datë 14.12.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 10-2015-1278 (567), datë 02.06.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 744, datë 30.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Sipas Kolegjit Civil, pala e paditur, në cilësinë e punëdhënësit, nuk ka respektuar procedurën në zgjidhjen e marrëdhënies së punës, ndaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë i ka njohur paditësit (kërkuesit) të drejtën e dëmshpërblimit me dy muaj pagë, ndërkohë që zgjidhja e kontratës së punës mes palëve nuk është një zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës.

8. Në datën 19.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe parimit të barazisë së armëve*, pasi ajo gjykatë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material të zbatueshëm, ndërsa vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në zbatim të drejtë të tij. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është abuziv dhe në shkelje të të drejtave të kërkuarit si punëmarrës, pasi ajo shprehet se ndryshimet në nenet 144 dhe 146 të KP-së nuk kanë ndikim në çështjen objekt gjykimi, pasi nuk ekzistonin në kohën e zgjidhjes së kontratës së punës. Këto rregullime ekzistonin në kohën e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, e cila, në shkelje të procedurës, pa njoftuar palët për shqyrtime rekursesh të vonuara në kohë, në mënyrë abuzive ka marrë vendim në dhomën e këshillimit, duke goditur vendimin e gjykatës së apelit. Ky i fundit është bazuar në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, që më pas ka sjellë edhe ndryshime në ligj. Gjykata e Lartë, në kundërshtim edhe me vetë praktikën e saj dhe ligjin, ka dhënë një vendim abuziv, në shkelje të të drejtave të punëmarrësit dhe në abuzim të pavarësisë dhe organizimit e mënyrës së veprimit të saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, në cilësinë e palës paditëse, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijene efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijene konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijene konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mban datën 14.12.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 19.03.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 04.06.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i saj nr. 00-2022-4395, datë 14.12.2022 është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 13.03.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët.

15. Ndërkohë, nga ana e kërkuesit, në ankimin kushtetues individual pretendohet se ai është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 23.02.2024, kur është njoftuar nga

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga shoqëria “Kurum International” sh.a., duke iu bashkëlidhur edhe vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë. Për të provuar këtë pretendim kërkuesi ka paraqitur, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, edhe njoftimin e datës 07.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, përmes të cilit i është njoftuar kërkesëpadia dhe provat e aktet e tjera të depozituara nga shoqëria “Kurum International” sh.a., e cila ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor kundër kërkuesit, me objekt kthimin e shumës 792,000 lekë, të përfituar nga ekzekutimi i vendimit nr. 10-2015-1278, datë 02.06.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës, që është prishur nga Gjykata e Lartë, pasi është përfituar pa shkak të ligjshëm dhe si rrjedhojë e begatimit pa shkak.

16. Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim në ankimin kushtetues në lidhje me mungesën e komunikimit të rekursit të palës tjetër në gjykim apo të mospasjes dijëni në lidhje me të, dhe as në drejtim të pamundësisë së tij për t`u informuar për gjendjen në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes së tij në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, për sa kohë që kërkuesi nuk ka pretenduar se ai nuk ka qenë në dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, ai ka pasur, gjithashtu, detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së tij. Pretendimi i kërkuesit në lidhje me momentin e marrjes dijëni për vendimin e kundërshtuar, në kushtet kur ai nuk ka paraqitur argumente ose prova, edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, për pamundësinë e marrjes dijëni, nga vetë ai ose mbrojtësi i zgjedhur, për vendimin e arsyetuar nga momenti kur ka qenë i disponueshëm për palët, nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se data e pretenduar prej tij është ajo e marrjes dijëni efektivisht për vendimin e kundërshtuar.

17. Nga sa më lart, duke analizuar argumentet e paraqitura nga kërkuesi në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijëni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

18. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimitimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

19. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.